40 HERË ËSHTË PEZULLUAR HAXHI!

18 DHJETORI, DITA BOTËRORE E GJUHËS ARABE



A E DINI CILI ËSHTË PËRKUFIZIMI I NEVERISË?

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Viti 22 - Nr. 12 (262), Dhjetor, 2024

www.myftinia-shkoder.org

MYFTINIASHKODER1990

Xhamia Umevi – Damask, Siri

CEREMONI NDERIMI PËR HUMANISTIN SAMI REPISHTI, MORI PJESË EDHE MYFTIU I SHKODRËS

PROF. DR. MEHMET GÖRMEZ: "SHOQËRIA ISLAME DHE KONCEPTI I YMETIT"

LUTJE E SEXHDE FALËNDERIMI, PËR TË BEKUARIN SHÂM!

AKTIVITET PËR DITËN BOTËRORE TË GJUHËS ARABE

LIGJËRATË ME VLERË: "SHËRIMI SIPAS KUR'ANIT DHE TRADITËS PROFETIKE"

PËRKUJTOHEN GJURMË TË HOXHALLARËVE SHKODRANË TË SHEKULLIT 19-20 NË QK TË MES-MYSELIMIT

40 HERË ËSHTË PEZULLUAR HAXHI!

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Të xhumanë, më 20 dhjetor 2024, hytebja e xhumasë në të gjitha xhamitë e vendit tonë ishte përqendruar tek Haxhi dhe rëndësia e tij, dobitë e Haxhit dhe nxitja e besimtarëve për të kryer Haxhin, duke u regjistruar për t'u bërë pjesë e grupit të haxhilerëve të këtij viti që nisen drejt vendeve të shenjta.

Mirëpo, ajo që kisha dëshirë për të tërhequr vëmendjen e besimtarëve, dje nga minberi i xhamisë së "Dy Vajzave", ishte fakti se përgjatë këtyre 15 shekujve ka një detaj shumë interesant që nuk duhet ta harrojmë; rreth **40 herë** në vite e shekuj të ndryshëm, Haxhi është pezulluar! Po, po, është pezulluar dhe njerëzit nuk kanë pasur mundësi për të kryer këtë adhurim të shenjtë, sikurse nuk kanë pasur mundësi për të plotësuar këtë shtyllë prej pesë shtyllave të Islamit.

Dhe ju do të habiteni, do të pyesni: "40 herë? Arsyeja? Çfarë ka ndodhur, përse është pezulluar Haxhi?" Do t'ju përmend disa raste, të cilat janë të verifikuara dhe të shënuara në librat e historisë sonë islame.

Historianët na tregojnë se fillimisht në vitin **865** u pezullua Haxhi i atij vitit për shkak të një konflikti të madh në mesin e popujve dhe luftërave që mbizotëronin në zonën e Hixhazit, në Gadishullin Arabik. Atë vit thuhet se pati vrasje deri në Arafat, domethënë deri në vendin më të shenjtë dhe në ditën më të shenjtë të vitit kishte vrasje, gjë që çoi në pezullimin e Haxhit të atij viti.

Në vitin **930** ka ndodhur një ngjarje jashtëzakonisht e çuditshme dhe e papranueshme prej asnjërit prej nesh, është vjedhur Guri i Zi! Po, po, Guri i Qabes, dhe për *22 vite* Guri nuk ka qenë i pranishëm në sheshin dhe në Shtëpinë e madhe të adhurimit në Mekë. Pas asaj periudhe janë kthyer disa copa të atij guri dhe janë vendosur aty ku janë edhe sot.

Në vitin **931**, Haxhi është zhvilluar në Gjesh të Katifit pas vendosjes së Gurit të Zi në një shtëpi të madhe atje nga karamitët!? Injoranca nuk ka kufi! Një fakt i çuditshëm dhe një realitet, me të cilin është përballur ymeti islam në kohët e lashta.

Në vitin **1037** ka pasur haxhilerë vetëm nga Misiri, pra vetëm nga Egjipti. Subhanallah, nuk e dimë arsyen, ndoshta për çështje politike kryesisht, por se në atë vit nuk janë pranuar haxhilerë nga asnjë vend i botës, përveç se nga Egjipti!

Në **1253** u rikthyen haxhilerët nga zonat e Irakut për të kryer adhurimin e shenjtë, pas *10 viteve* të pezullimit të Haxhit për ato zona. Subhanallah, kjo më sjell ndër mend Shqipërinë dhe shqiptarët, që më e pakta nga viti *'67 dhe deri në vitin 1990*, falë terrorizmit komunist dhe dhunës barbare të sistemit më totalitar dhe më tiran, që ka njohur shekulli dhe që kishte pushtuar Shqipërinë, i ndaloi shqiptarët, muslimanët për të kryer Haxhin. Subhanallah, imagjinoni gëzimin dhe emocionin e Hfz. Sabri Koçit dhe të sa e sa haxhilerëve shqiptarë të atyre viteve, kur për herë të parë shkelën në Tokën e Shenjtë, pas dekada ndalimi të Haxhit edhe në vendin tonë.

Në vitin **1814** në Gadishullin Arabik ra murtaja, rreth 8000 të vdekur!

Në **1831** gripi indian, që vrau 3/4 e Gadishullit Arabik, u përhap në Haxh dhe 3/4 e haxhilerëve ndërruan jetë, u pezullua Haxhi!

Në vitin **1837** deri ne 1840

Sot e ke shëndetin, sot e ke sigurinë, sot e ke garancinë për të shkuar në vendet e shenjta, sot e ke mundësinë ekonomike, prandaj mos ngurro, mos thuaj do ta shtyj për vitin tjetër ose për një vit më pas, sepse nuk e di a ke garanci për jetën tënde, a ke garanci për shëndetin tënd, a ke garanci për diçka që nuk është në dorën tënde, si rasti i pandemisë apo edhe rastet e tjera, siç i përmenda më lart dhe i përmenda me detaje dje në hytben e xhumasë.

është përhapja e shumë epidemive që ndalojnë kryerjen e Haxhit.

Në **1846** përhapja e kolerës deri në **1850**, pastaj u kthye në vitin **1865** dhe **1883**. Pra, imagjinoni periudha ku siguria, ku mundësia për ta kryer Haxhin, jashtë vullnetit të njeriut, pra jashtë pasurisë dhe jashtë shëndetit: bëhen shkak që njeriu, besimtari, adhuruesi mos të ketë mundësi të shkojë në vendet e shenjta!

Prandaj e kemi thënë disa herë, për të kryer Haxhin nuk mjafton thjesht të kesh shëndet të plotë dhe të kesh pasuri, duhet siguria, garancia e rrugës dhe e mundësive që të lejojnë për të hyrë në atë vend, ku kryhet Haxhi dhe të jetë qetësi, të jetë ambienti i përshtatshëm, i pastruar nga epidemitë dhe sëmundjet e ndryshme, që mund të bëhen shkak për ndalimin e Haxhit, siç janë bërë shkak edhe në vitet e shekujt e kaluar.

Në vitin **1858** arratisja e njerëzve nga Hixhazi, pra nga Gadishulli Arabik drejt Misirit pas një epidemie të frikshme për pasojë ishte boshatisur edhe Qabja e madhërueshme dhe ishte pezulluar Haxhi.

Në vitin **1864** është vdekja e 1000 haxhilerëve në ditë, si pasojë e një epidemie të frikshme që ra në periudhën e Haxhit, Haxhi u pezullua!

Në vitin **1892** ra kolera dhe nuk kishte kohë për të varrosur kufomat nga numri i madh i të vdekurve, u pezullua Haxhi.

Në **1895** tifoidi.

Në **1897** meningjiti, 10 mijë infektime dhe nga ajo kohë e deri më sot, të gjithë haxhilerët apo umrexhitë që shkojnë për të kryer Umren apo Haxhin e kanë obligim për të bërë vaksinën e meningjitit.

Të dashur dhe të shtrenjtë,

Jo shumë larg nga koha e jonë, pak vite më parë, falë asaj lufte të madhe botërore që mori jetë njerëzish të pafajshëm, përhapja në masë e pandemisë së korona virusit, e patë edhe ju vetë se Haxhi u pezullua, sikurse u pezullua në mbarë botën jeta normale e njerëzve, që do të thotë se: sot e ke shëndetin, sot e ke sigurinë, sot e ke garancinë për të shkuar në vendet e shenjta, sot e ke mundësinë ekonomike, prandaj mos ngurro, mos thuaj do ta shtyj për vitin tjetër ose për një vit më pas, sepse nuk e di a ke garanci për jetën tënde, a ke garanci për shëndetin tënd, a ke garanci për diçka që nuk është në dorën tënde, si rasti i pandemisë apo edhe rastet e tjera, siç i përmenda më lart dhe i përmenda me detaje dje në hytben e xhumasë.

Prandaj të dashur besimtarë, të shpejtojmë dhe mundësitë që na i ka dhënë Allahu i Madhëruar; kujtdo që ia ka dhënë për të kryer Haxhin, t'i shfrytëzojë dhe t'i përgjigjet Allahut (xh.sh) me *lebbejke*..!

LUTJE E SEXHDE FALËNDERIMI, PËR TË BEKUARIN SHÂM!

"Vitet dhe jeta kalojnë. Mbetet e gdhendur në zemër dashnia dhe lidhja e patjetërsueshme me tokën e bekuar, me Shâm Sherifin e eulijave dhe dijetarëve, para të cilëve mësuam e u rritëm, për të qenë këta që jemi!

Në venat tona, me gjakun përzihet uji i Fixhës e Beredasë, mushkëritë tona ruajnë aromën e ajrit të Kasijunit e, në memorie është gdhendur lista e gjatë e xhamive dhe ulemave të tokës tënde, Shâm i zemrës!

Vitet dhe jeta kalojnë. Kalojmë sëbashku, si rrjedha të heshtura, a të zhurmshme, lumenjsh plot degëzime, që derdhen në një vend të përbashkët...

Vitet dhe jeta kalojnë. Mbetet në gene lidhja frymëzuese dhe prekja identitare e përkatësisë së shenjtë, aroma e jaseminës dhe drita e përhershme në çdo horizont, hapësirave të Shâm Sherifit!

Shâm..! Djepi i lashtë i fisnikërisë dhe vullneteve të lira për të jetuar me dinjitet e krenari!

Shâm i zemrës e fymë e vullnetit, elf mabruk, këtë ditë të bekuar ezanesh të lira në tokën e sahabëve e prehrin e eulijave!"

Imam Muhamed B. Sytari
Në lutje e sexhde falënderimi, më 8/12/2024

MESAZHI I MINISTRIT TË VAKËFEVE TË EGJIPTIT, PËR IMAMËT, MUEZINËT DHE UDHËHEQËSIT E XHAMIVE

Të dashur vëllezër!

Unë dua që ju të keni disiplinën maksimale administrative në xhami. Dëshiroj që ju të nderuar imamë, predikues, nëpunës, muezinë dhe punonjës pranë Ministrisë së Vakëfeve, të jeni në nivelin më të lartë të disiplinës. Kërkoj prej jush (imamëve) që të jeni të përkushtuar në punën tuaj, dhe gjatë kryerjes së shërbimeve fetare të mbani uniformën fetare (xhyben dhe çallmën). Përgatituni mirë para çdo predikimi dhe përmbajuni kohës së hutbes (mos e zgjatni shumë). Jini gjithmonë të sinqertë, menaxhoni mirë kohën dhe me punën tuaj përpiquni të arrini afërsinë dhe pëlqimin e Allahut.

Përveç disiplinës administrative, dua që ju (imamë dhe punëtorë administrativ) të jeni në shkallën më të lartë të mikpritjes dhe bujarisë ndaj mysafirëve të Zotit (besimtarëve/xhematlinjve). Ata që shkojnë në xhami nuk janë mysafirët tuaj, as nuk janë mysafirët e mi, ata janë mysafirët e Allahut, Zotit të botëve. Andaj trajtoni mirë ata, respektoni, nderoni, pritni me ngrohtësi të përzemërt vëllazërore, dhe kjo këshillë vlen për mua si ministër e pastaj për të gjithë anëtarët e Ministrisë së Vakëfeve. Të gjithë ne duhet të jemi në shërbim të mysafirëve të Zotit. Unë jam i pari që kam nderin t'u shërbej xhamive dhe t'u shërbej besimtarëve që vizitojnë xhamitë.

Imamë të nderuar!

Pas namazit të xhumasë, mos e ndërpritni lidhjen me xhaminë dhe xhematin. Njerëzit përherë kanë nevojë për ju, për këshillat e juaja, prandaj duhet të jeni të pranishëm kudo që ju kërkon nevoja, si brenda ashtu edhe jashtë xhamisë. Jetoni me njerëzit në zonën përreth xhamisë ku veproni, mësoni emrat e tyre, vizitoni, vlerësoni dhe nderoni, jetoni me ta që të kuptoni shqetësimet e tyre dhe mundohuni maksimalisht që të largoni apo lehtësoni brengat dhe vuajtjet e tyre.

Ju do të takoni njerëz që kthehen nga ju sikur të ishin kthyer nga dera e Zotit. Çdo ditë vijnë tek ju njerëz nevojtarë, njerëz që kanë probleme, halle e shqetësime nga më të ndryshmet, të cilët kërkojnë ndihmën tuaj, këshillat tuaja. Ata vijnë pranë derës së Zotit, e dera e Zotit jeni ju, prandaj silluni mirë, flisni me ta me butësi, lehtësojuni dhimbjet e tyre dhe trajtoni me dhembshuri ashtu siç i trajtonte njerëzit më i dashuri i Zotit, Muhammed Mustafaja (paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të).

Prof. Dr. Usame Al-Az'heri
Ministër i Vakëfëve
24 Dhjetor 2024, Kajro.

Përktheu dhe përshtati:
Enes Koshi
Saint Gallen, Zvicër

H. Vehbi S. Gavoçi
(1923 - 2013)

Besimi në Zotin (xh.sh), që ka krijuar jetën dhe vdekjen, është një sistem i plotë logjik që i jep kësaj gjithësie kuptimin e duhur.

Besimi në Zotin (xh.sh) është përroi më i thellë i mendjes njerëzore, është shtylla që në të bazohet vëllazërimi njerëzor, dashuria e mirësia ndaj të tjerëve si për vetveten. Besimi më vonë e shtyn besimtarin të lidhet më mirë me Krijuesin (xh.sh), të dojë kërkesat e Tij e të përpiqet t'i zbatojë ato.

Besimi në Zotin (xh.sh) është kalaja, e cila e mbron njeriun nga të keqijat dhe ia pasuron jetën shpirtërore, sa të jetë gjallë!

(Nga libri: Si forcohet e si vërtetohet besimi?)

KIBLA E JETËS

Naim Drijaj
Imam - xhamia e Parrucës

Nga mësimet e rëndësishme që Allahu (xh.sh) na i ka treguar në librin e Tij janë edhe mësimet që kanë të bëjnë me kuptimin e drejtë të jetës. Jeta që ne gëzojmë padyshim që është një begati e madhe që Allahu (xh.sh) na ka dhënë dhe duhet ta vlerësojmë siç duhet.

1. Jeta e ka një qëllim (synim). Kur Allahu (xh.sh) në Kur'an flet për jetën dhe për krijimin tonë fillimisht Ai thotë se jeta në këtë botë e ka një qëllim (një synim). Këtë qëllim, që Allahu i Madhëruar e përmend në Kur'an, besimtari duhet ta ketë parasysh gjithmonë si një lloj kibleje (drejtimi), ai çdoherë duhet të jetë i orientuar nga ajo dhe çdo lëvizje e tij duhet të jetë në drejtim të kësaj kibleje. Ashtu sikur namazi që e ka një kible, po ashtu edhe jeta e ka një kible, e ajo është orientim nga Allahu, ku për këtë Zoti (xh.sh) në Kur'an thotë: "Thuaj: Namazi im, sakrifica jeta dhe vdekja ime (e kanë një orientim) janë për Zotin e gjithësisë!"[1]

Prandaj, para çdo veprimi që merr në jetë dhe para çdo lëvizje që bën, interesohu e thuaj: Kjo që unë po veproj, a është nga kibla? A është Allahu i kënaqur me veprimin që unë po bëj? Allahu flet në Kur'an për forcën organizative të këtij orientimi. Ai thotë: "Unë nuk i krijova xhindët dhe njerëzit për gjë tjetër, por veç që të më adhurojnë Mua!"[2]

2. Jeta është mundësi. Jeta me të gjithë përbërësit e saj të këndshëm dhe të pakëndshëm është e dashur për njeriun, por ajo gjithashtu e ka një fund. Jeta është një mundësi ku njeriu ose e shfrytëzon siç duhet ose dështon. Allahu (xh.sh) na tregon në Kur'an, që sapo të përfundojë mundësia nuk ka kthim pas. Xheneti i Allahut është i shtrenjtë. Ndërmjet tij dhe njerëzve ka pengesa, rreziqe dhe vështirësi, të cilat e bëjnë të arritshëm vetëm me kapërcimin e tyre.

Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Me të vërtetë malli i Allahut është i shtrenjtë, me të vërtetë malli i Allahut është xheneti!"[3] Çmimi që Allahu po na ofron është shumë i shtrenjtë, por Ai me mëshirën e Tij na ka mundësuar që me jetën e kësaj bote ta blejmë xhenetin.

Kur njeriu lexon në Kur'an për mjerimin e banorëve të xhehenemit dhe përjetimet e tmerrshme të tyre, mendon dhe thotë: Çfarë i ka bërë këta njerëz që të mos e fitojnë mëshirën e Allahut? Zoti (xh.sh) thotë: "Kjo është humbje e madhe (dështimi i madh) me të gjitha mundësitë që ata i kishin!"[4] Atyre do t'u thuhet: "Shijoni ndëshkimin tuaj![5] (hidhësinë e sprovës që nuk arritët ta kalonit). Humbjen e kësaj jetë njerëzve nuk ua ka shkaktuar ngjyra, prejardhja, etj, por punët e tyre.

Allahu (xh.sh) në suren Mu'minun na tregon për kërkesën e të dështuarve, të cilët do të thonë: "O Zot! Më kthe, ma jep edhe një mundësi që të bëj vepra të mira. Allahu (xh.sh) do t'i thotë: "Jo, kurrsesi. Këto janë vetëm fjalë boshe (e pate mundësinë dhe nuk e shfrytëzove)![6] Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Atë që e lë prapa vepra e tij, nuk do ta çojë përpara prejardhja e tij!"[7] Xhaxhai i Pejgamberit (a.s), Ebu Lehebi ishte me prejardhje fisnike, por Allahu e mallkoi atë në Kur'an dhe do të jetë në xhehenem përjetësisht. Kurse, Bilali (r.a) ishte me ngjyrë të zezë, ai ishte muezini i Pejgamberit (a.s) dhe i përgëzuar me xhenet qysh në dynja. Ja, pra ky është Islami. Allahu (xh.sh) na tregon në Kur'an për ata që i shfrytëzuan mundësitë për të bërë mirë në këtë botë edhe për ata që nuk i shfrytëzuan. Në lidhje me këtë do sjell dy shembuj:

1. Në suren Jasin do të gjejmë, se si një njeri e shfrytëzoi mundësinë që ia dha Zoti dhe si pasojë e shfrytëzimit të kësaj mundësie e fitoi xhenetin. Allahu (xh.sh) në Kur'an na tregon për një vendbanim në të cilin ka dërguar pejgamber, por ai popull i refuzonte pejgamberët, i luftonte dhe nuk e donin të vërtetën. Një besimtar nga populli u bë përkrahës i pejgamberëve duke thënë: "O populli im! Ndiqni të dërguarit!"[8] Nuk tha e nuk bëri më shumë se kaq, ngase nuk kishte mundësi më shumë. Ai e shfrytëzoi mundësinë që kishte duke e thënë fjalën e tij dhe fatkeqësisht ata e vranë. Atij iu tha: "Hyr në xhenet!"[9] Ti mundësinë që pate e shfrytëzove.

2. Allahu (xh.sh) na tregon për Faraonin, i cili nuk e shfrytëzoi mundësinë që Zoti ia kishte dhënë. Faraoni nuk e shfrytëzoi mundësinë për t'u penduar kur Musai (a.s) e ftoi në besim, nuk e shfrytëzoi begatinë e pushtetit që Allahu ia dha, nuk e shfrytëzoi mundësinë për tu penduar kur u mposhtën magjistarët e tij. Kur Allahu e fundosi në det kërkoi një mundësi, por Allahu nuk ia dha![10]

Jeta është mundësi prandaj shfrytëzoje siç duhet. Mos e nënçmo asnjë punë të mirë dhe mos e injoro asnjë punë të keqe. "Pa dyshim, kthimi është tek Allahu"[11] Të gjithë do të dalim para Allahut, disa krenarë, kokëngritur e të privilegjuar me shpërblime te Allahu e disa kokulur, të poshtëruar e të nënçmuar për arsye që nuk e shfrytëzuan jetën siç duhet por e keqpërdorën atë.

1. Kur'ani, El-En'am: 162.
2. Kur'ani, Edh-Dharijat: 56.
3. Transmeton Tirmidhiu.
4. Kur'ani, Ez-Zumer: 15.
5. Kur'ani, Edh-Dharijat: 14.
6. Kur'ani, El- Mu'minun: 99-100.
7. Transmeton Muslimi.
8. Kur'ani, Jasin: 20.
9. Kur'ani, Jasin: 26.
10. Kur'ani, Junus: 90-92.
11. Kur'ani, El-Alak: 8.

A E DINI CILI ËSHTË PËRKUFIZIMI I NEVERISË?



Ihsan El-Fekih

Thjesht është kujdesi i të gjithë botës për të siguruar të drejtat e pakicave në Siri, frika dhe dhembshuria e tyre e tepruar, që papritmas ra mbi planetin tonë, dhe humanizmi i tyre që u shfaq nga asgjëja, pa e ditur se në vatrën e kujt u krijua dhe kujdesi e shqetësimi i tyre i vazhdueshëm për ta!?

A nuk është kjo neveri që po ndodh tani një nga hipokrizitë më të mëdha në historinë njerëzore?

Kjo është e njëjta neveri dhe hipokrizi që Perëndimi dhe shërbëtorët e tij (nga radhët tona) praktikuan kur trajtuan dhe gjykuan reagimin e palestinezëve më 7 tetor ndaj armikut të tyre pushtues gjakatar, që i ka dëbuar, torturuar, vrarë dhe shtypur për më shumë se shtatëdhjetë vjet!

Mos e besoni këtë hipokrizi dhe mos lejoni askënd t'ju spostojë a t'ju turpërojë, sado i sjellshëm dhe i respektueshëm të jetë, madje edhe nëse është prej njerëzve të ndershëm të këtyre "pakicave". Ne e dimë dhe e pranojmë se nga këto pakica kanë dalë dhjetëra njerëz fisnikë dhe të lirë, të cilëve nuk ua ulim vlerën dhe as nuk na takon t'ua mohojmë qëndrimet e tyre të mira.

Por, e vërteta thotë, se Siria është qeverisur nga bijtë e një pakice për 54 vite, dhe këta (me bashkëpunimin e disa pakicave të tjera) kanë kryer gjenocid kundër shumicës. Ata kanë tmerruar, terrorizuar, vrarë, grabitur, plaçkitur, dëbuar dhe arrestuar 9 milionë njerëz nga bijtë e shumicës.

Pra, numri i atyre që kanë pësuar dëme është më shumë se nëntë milionë sirianë! Ata me të vërtetë janë prej shumicës dhe ndoshta ka edhe me dhjetëra prej pakicave në rrethin e këtij numri të madh.

A po gënjej, a po e teproj në këtë?

Kundërshtomëni nëse mundeni!

Të gjitha imazhet (pamjet) e egërsisë brutale dhe të përgjakshme që shihni nga Siria e Asadit, janë krime të urdhëruara nga individë të pakicave, pa marrë parasysh se kanë qenë prej ushtrisë, policisë apo sigurimit, në dëm të njerëzve të shumicës.

A po gënjej, a po e teproj në këtë?

Të gjithë refugjatët sirianë që jetojnë nëpër çadra, prej atyre që u janë dërrmuar kockat nga i ftohti dhe moti i keq, të cilët i kanë baltosur rrëketë e baltës dhe u janë sulmuar çadrat e tyre, për t'i lënë në vapën e ditëve të nxehta të verës duke i përvëluar flaka e tyre, janë nga shumica synite, 100%. (Asnjë durzi, asnjë i krishterë dhe asnjë alevit nuk ka jetuar në çadra për 54 vite!)

A po gënjej, a po e teproj këtu, apo po nxis kundër pakicave!?

A është thënia e të vërtetës dhe tregimi i thikave të vrasësit nxitje, o njerëz?!

Të gjitha bombardimet me avionë, fuçi eksplozive, kimikate ose armë të ndaluara (200 mijë raste bombardimesh) kanë qenë bombardime kundër njerëzve të shumicës synite, 100%. Asnjë i krishterë, durzi apo alevit nuk është bombarduar, as edhe një herë të vetme për 54 vite!

As nuk ua shpresojmë atyre një gjë të tillë dhe as nuk ua shpresojmë asnjë qytetari në tokë ta pësojë diçka të tillë.

Por, përse nuk flisni qartë për këtë të vërtetë, o ju turmë e ndjekësve, njohësve dhe të ardhurve për të kërkuar, hulumtuar dhe arritur tek e vërteta apo një pjesë e saj?!

Çdo lagje e shkatërruar në Siri është një lagje synite e bombarduar nga një oficer alevit. (Nuk ka, qoftë edhe një ndërtesë të vetme të shkatërruar, që të jetë banuar nga alevitë, durzë apo të krishterë).

Larg qoftë, që të shpresojmë për cilindo banor, që t'i shembet shtëpia mbi kokën tij!

Por, përse nuk bëhet e ditur me forcë dhe me detaje kjo gjë, pa asnjë kompliment?!

E me gjithë tërë këtë, një tjetër pakicë, në lindje dhe veri të Sirisë, ushtrojnë një politikë raciste kundër shumicës dhe vjedhin 70% të pasurive të Sirisë dhe 100% të mallrave strategjikë (si: nafta, gazi, uji, energjia elektrike, gruri, pambuku dhe bagëtia), dhe bota mbarë është e shqetësuar (dhe sa e sa do të qajnë dhe do të ulërijnë ditëve të ardhshme) për të drejtat e pakicës dhe të hajdutëve!



Vrasësi në Siri për 54 vite ka qenë prej pakicave, ndërsa viktima ka qenë prej shumicës, dhe e tërë bota është e interesuar për të drejtat e vrasësve (dhe sigurimin e tyre) që të shpëtojnë nga dënimi që e kanë hak, ndërsa viktima nuk paska të drejtë të vendosë kufirin për vrasjet dhe vjedhjet!?

Ju sfidoj, që të keni dëgjuar, qoftë edhe një njeri të poshtër (në rrethet e vendimmarrjes) në këtë botë të fëlliqur që të flasë për garantimin e të drejtave të shumicës, kompensimin e shumicës, ose të paktën për garantimin e mos përsëritjes së asaj, që shumica synite ka përjetuar prej tmerrit dhe mizorive barbare.

Më e rrezikshmja e kësaj gjëje, është se bijtë e shumicës nuk guxojnë të thonë këto të vërteta, pavarësisht se ka rënë sundimi i pakicës dhe është arratisur lideri i saj, sepse mendja e sirianëve, media e tyre dhe kultura e tyre kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë nën kontrollin e pakicave. I fundit prej tyre është një person i mbështetur nga qeveria e një prej vendeve arabe, i cili tani kontrollon 95% të shkrimtarëve, gazetarëve, intelektualëve dhe elitave siriane, madje edhe atyre jo-siriane për fat të keq, dhe ai ka një orientim më të rrezikshëm dhe më të neveritshëm se orientimi laik, pasi orientimi i tij ka për qëllim gjithçka që është islame, me butësi dhe infiltrime në pallatet arabe sunduese, të cilat ende nuk e kanë zbuluar fëlliqësinë, dinakërinë dhe rrezikun e tij!

Unë për të një mijtën herë drejtohem me thirrje për ndihmë të ndershmëve muslimanë dhe arabë, për të krijuar një media siriane, bile arabe, të çliruar nga dominimi i pakicave (dhe prej tyre, pakicat sekulare të egra dhe kundër Islamit, fetarizmit dhe manifestimeve islame, të cilat kontrollojnë foltoret më të rëndësishme muslimane).

"Allahu është Triumfues i çështjes së Tij, por shumica e njerëzve nuk e dinë!" – (Kur'ani, Jusuf: 21)

Përktheu nga arabishtja
dhe përshtati në shqip:
Lavdrim Hamja

MARRËDHËNIA BABË-DJALË, NË AMANETIN E HZ. IBRAHIMIT DHE HZ. JAKUBIT!

Ditën e xhuma, më datë 6 dhjetor 2024, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari mbajti dërsin e xhumasë në xhaminë e "Dy Vajzave".

Nëpërmjet komentimit të ajetit 132, të sures El-Bekare, Myftiu u ndal te disa stacione shumë të rëndësishme në edukimin e brezit të ri.

Ndër të tjera, ai theksoi: "Në prag të vdekjes, Hz. Ibrahimi i la ca amanet djemve të tij. Poashtu, Hz. Jakubi, nipi i tij. Ajeti 132 i sures "El-Bekare", është në të vërtetë një seri leksionesh të pashembullta, që i nevojiten çdo prindi për të dështuar aftësitë e tij në edukim, sipas hartës së udhëzimit hyjnor.

A dimë ne sot, të edukojmë fëmijë besimtarë, zemërgjerë, bujarë, të pastër, të ndershëm e xhelozë për nderin e shenjtëritë e veta? A dimë ne të lexojmë ajetet kur'anore, nëpërmjet të cilave ftohemi të jemi njerëz të ekuilibruar, të matur, ndërtues e të denjë për të mbajtur mbi supe amanetet e shtrenjta të më të mirëve?"

Tema e edukimit të brezit të ri dhe rinisë është patjetër një ndër tematikat më të ndjeshme në kohët që po kalojmë. Myftinia Shkodër nëpërmjet udhëzimeve, që i ka dhënë imamëve të saj po tërheq vëmendjen e shoqërisë herë pas here për të qenë të vëmendshëm në këtë çështje shumë të rëndësishme, që i shërben ndjenjës fetare dhe asaj kombëtare.

KUJDES FËMIJËT, JETOJMË KOHË TË VËSHTIRA!

Ditën e xhuma, më 13 dhjetor 2024, në vazhdën e një cikli ligjëratash kushtuar çështjes së edukimit të fëmijëve dhe marrëdhënieve prind fëmijë, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, vijoi me tefsirin e ajetit 132 të sures El-Bekare, ku ndër të tjera u ndal te rëndësia e komunikimit dhe hapjes së rrugëve të dialogut ndërmjet prindit dhe fëmijës, ku theksoi se: "Kujdes fëmijët, jetojmë kohë të vështira! Investohen qeveri, shoqata e fondacione për të prishur moralin, besimin, vlerat dhe tabanin!

Dita-ditës po vërtetohet tendenca e rrëshqitjes në idhujtari e diktaturë të afetarizmit dhe islamofobisë, nëpërmjet shfaqjeve të dhunshme të festimeve marramendëse, pa asnjë vlerë e pa asnjë dobi, plot zhurmë e promovim të alkoolit e shthurjes, në zemër të lagjeve muslimane, por jo vetëm!

Amaneti i ruajtjes së besimit e fesë, që e hasim në shumë ajete kut'anore, është promovim i lirisë dhe të jetuarit me dinjitet, që nxit Libri i Allahut dhe mësimet e dritshme të fesë islame. Uluni dhe flisni me fëmijët tuaj, mos iu përgjigjuni thirrjeve të pamoralshme dhe tunduese, të kujtdo, që punon ditë-natë, me dije a pa dije, në rrugën e shkatërrimit të vlerave!"

Ky është një cikël i ri ligjëratash javore, që Myftiu i Shkodrës po jep në xhaminë e "Dy Vajzave" me theks te rëndësia që ka kjo temë në realitetet e sotme shqiptare, por jo vetëm.

18 DHJETORI, DITA BOTËRORE E GJUHËS ARABE

Arben Halluni, *teolog*

"Ne e zbritëm atë Kur'an arabisht, ashtu që ju ta kuptoni!" *- (Kur'ani, Jusuf:2).*

Pa dyshim, Dita Botërore e Gjuhës Arabe, e cila festohet çdo vit më 18 dhjetor, është një ngjarje ndërkombëtare e caktuar nga organizata UNESCO që ka për qëllim të nderojë gjuhën arabe dhe trashëgiminë e saj të pasur kulturore, historike dhe intelektuale.

Kjo ditë shënon pranimin e gjuhës arabe si një nga 6 gjuhët zyrtare të Kombeve të Bashkuara, pikërisht më 18 dhjetor 1973.

Ajo shërben si një platformë për të promovuar rëndësinë e gjuhës arabe si një mjet për dialog, zhvillim kulturor dhe shkëmbim ndërkulturor.

Gjuha arabe është një nga gjuhët më të vjetra në botë, me një histori që shtrihet për më shumë se 15 shekuj. Ajo është një gjuhë amtare për mbi 400 milionë njerëz dhe përdoret si gjuhë e dytë nga miliona të tjerë. Arabishtja është gjithashtu gjuha e Kur'anit Famëlartë, duke i dhënë një përmasë të madhe shpirtërore për myslimanët në mbarë botën.

Në aspekt të kontributeve në shkencë dhe kulturë, në periudhën e artë të qytetërimit islam shek. 8-13, arabët kontribuuan në zhvillimin e shkencave, filozofisë dhe artit.

Vepra madhore nga fusha e astronomisë, mjekësisë dhe matematikës u përkthyen në arabisht dhe u ruajtën për brezat e ardhshëm.

UNESCO përmes kësaj ditë synon që të rrisë:

1. Rritjen e ndërgjegjësimit për gjuhën arabe, sepse promovimi i rëndësisë së saj është si një mjet shumëllojshmëri kulturore dhe gjuhësore.

2. Nxitja e dialogut ndërkulturor: Arabishtja luan një rol kyç në ndërtimin e urave ndërmjet kulturave të ndryshme.

3. Ruajtja e trashëgimisë gjuhësore: Përballë modernizimit dhe globalizimit, kjo ditë synon të inkurajojë ruajtjen e gjuhës arabe për brezat e ardhshëm.

Nëse, rusishtja ka 130.000 fjalë, gjermanishtja ka 160.000 fjalë, frëngjishtja ka 150.000 fjalë, ndërsa, anglishtja ka 600 000 fjalë. Po gjuha arabe? Ajo ka më shumë se ***12 milion*** fjalë.

Pra, e tejkalon anglishten me 25-fish. As që mund të krahasohet! Është numër shumë i madh i fjalëve që të bën me dije për dallimin e gjerë mes gjuhës arabe dhe gjuhëve të tjera.

"Ne e zbritëm atë Kur'an arabisht, ashtu që ju ta kuptoni!" - (Jusuf:2).

Gjuha arabe nuk u quajt "arabishte" shkaku i arabëve, por arabët u quajtën arab, shkaku i arabishtes, sepse arabishtja është më e fortë se racat, më e fortë se fiset, më e fortë se etnitetet, më e fortë se identitetet lokale dhe rajonale.

Prandaj, arabishtja është gjuha më e fortë definitivisht dhe pa mëdyshje më madhështorja dhe më e bukura sigurisht.

Prandaj, Allahu xh.sh. e zgjodhi arabishten që të jetë bazamenti mbi të cilin e vendosi shpalljen Hyjnore, Prandaj, nuk ka gjuhë tjetër në botë që mund t'i përballojë bukurisë së kësaj shpallje Hyjnore dhe thellësisë së kuptimeve të saj, përveç një gjuhe dhe ajo është gjuha arabe.

Si përfundim,

Dita Botërore e Gjuhës Arabe nuk është vetëm një festë për folësit e saj, por edhe një mundësi për të gjithë botën që të njohë rëndësinë dhe pasurinë e kësaj gjuhe. Arabishtja nuk është thjesht një gjuhë, por një simbol i identitetit, diversitetit dhe trashëgimisë së përbashkët të njerëzimit.

Ruajtja dhe promovimi i saj janë thelbësore për të mbajtur të gjallë kontributet e saj për zhvillimin në të gjitha lëmit e jetës.

CEREMONI NDERIMI PËR HUMANISTIN SAMI REPISHTI, MORI PJESË EDHE MYFTIU I SHKODRËS

Ditën e xhuma, më 6 dhjetor 2024, Universiteti i Shkodrës dhe familja Repishti organizuan homazhe për personalitetin dhe humanistin shqiptar, Prof. Sami Repishti, i ndarë nga jeta pak ditë më parë, në moshën 99 vjeçare, në ShBA.

Të pranishëm në këtë ceremoni homazhi ishin autoritete fetare dhe civile, pedagogë, miq dhe familjarë.

Gjatë kësaj ceremonie u mbajtën fjalime vlerësime dhe nderimi për figurën e tij, nga rektori i universitetit, Prof. Dr. Tonin Gjuraj, z. Maxhid Cungu, znj. Ardita Repishti, etj, ku në fjalët e tyre përshëndetëse u vlerësua kontributi i Prof. Repishtit dhe rëndësia e ruajtjes së trashëgimisë së tij.

Kjo ceremoni nderimi u mbyll me mesazhet e të pranishmëve në librin e ngushëllimeve, në mes tyre edhe Myftiu I Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, për humanistin dhe simbolin e qëndresës ndaj regjimit kriminal komunist si dhe një luftëtar për të drejtat e liritë njerëzore.

Kush ishte Prof. Sami Repishti?

Profesor Sami Repishti u lind në gjirin e familjes së Hafiz Ibrahimit dhe Hava Bushatit në lagjen Dudas në Shkodër më 6 prill 1925. I ati ishte figurë me autoritet në shoqërinë shkodrane të asaj kohe dhe më pas deputet në Kuvendin Kombëtar. Në vendlindje kreu mësimet fillore në shkollën "Oso Kuka" dhe të mesmen pranë gjimnazit të Shkodrës, ku ra në kontakt edhe me lëvizjen komuniste.

Më 1942 mbaron maturën. Merr pjesë në një konkurs në Tiranë për studime të larta jashtë shtetit. 112 kandidatura, konkurronin për 28 bursa studimi të profesioneve të ndryshme. Mbas 2 ditëve, mësoi se e kishte fituar bursën nga Ministria e Arsimit për në Fakultetin e Historisë së Firences.

Me mbërritjen në atdhe më 1943 shkon të verojë në Repisht, prej ku kishte origjinën familja e tij. Duke qenë se strehoi një nip të tijin që kishte ide komuniste, autoritetet fashiste arrestojnë të atin dhe e torturojnë duke sjellë vdekjen e tij prej hemorragjisë më dt. 29 shtator 1943. Samiu duke qenë i pari i shtëpisë detyrohet t'i sigurojë bukën familjes.

Punon në Sektorin e rindërtimit me të hyrë në pushtet regjimi i ri. Themelon me shoqërinë e tij një Organizatë të Rinisë Demokratike, shpërndanë trakte dhe i dorëzuan një Memorandum një deputeti anglez që vizitoi Shkodrën dhe ndihmonin familjet e të arratisurve.

Në maj të 1946 mori pjesë në proçesionin e varrimit të Arqipeshkvit Imzot Gaspër Thaçi. Ishte data 22 tetor 1946, kur e arrestojnë forcat e sigurimit në vendin e punës me akuzën "Agjitacion e propagandë kundër shtetit". Për 14 muaj, iu nënshtrua hetimeve intensive ku takon dhe prof. Kolë Prelën. Dënohet nga pretenca e gjyqit me 15 vjet heqje lirie, në burg do shoqërohej me P. Çiprian Nikën dhe vëllanë e prof. Kolës, Markun.

Më 28 nëntor 1947 dërgohet në Burgun e Madh dhe më tej në kampin e Vloçishtit dhe në Beden të Kavajës më 1948. Mbas kampit të punës së detyruar në Orman Pojan të Korçës, rikthehet në burgun e Shkodrës, në fund të muajit nëntor.

Mbas daljes nga burgu më 1956 punoi javën e parë si pastrues i barit të keq në stadium, javën e dytë e caktojnë të punojë në kanalizimin e tokave të Qendrës Zooteknike. Kështu e gjeti edhe viti 1956.

Më vonë si ndihmës karpentier deri në ditën e arratisjes, 22 gusht 1959. Në Jugosllavi izolohet; lirohet nga izolimi në prill 1961dhe punësohet përkohësisht (ndërkohë studion serbokroatishten dhe anglishten.) Por shumë shpejt (qershor 1961), përfundon në kampin e refugjatëve të Gerovës, Kroaci.

Më 1 shtator 1961, arratiset nga kampi i Gerovës dhe vendoset në Itali. Qëndroi në Trieste, në kampin e refugjatëve San Sabba, ku në tri javë fitoi të drejtën e azilit politik.

Mbas një qëndrimi gjashtëmujor në kampet e Capua-s dhe Latina–s, pranë Napolit dhe Romës, mbas shumë vuajtjesh, më 9 prill 1962, emigroi për në ShBA. Merr pjesë në takimin e pesëdhjetë vjetorit të "Vatrës", ku dhe takon mikun e të atit në periudhën e opozitarizmit, Imzot Nolin. Fitoi qytetarinë (citizenship) amerikane më 1968.

Doktoroi pranë Departamentit të Frëngjishtes në City University of New York (1977). Për 25 vjet me radhë, ka dhënë mësim në kolegjet amerikane. Ka qenë kryetar i Departamentit të Gjuhëve të Huaja, për shkollat e qytetit Malverne, New York, koordinator i programit për studime të avancuara, versity, Adelphy, Garden Lice-UniCity, NY, 1976-1991 dhe po aty pedagog i jashtëm. Udhëtimin e vetëm në Kosovën e çliruar e realizoi në prillin e 2000.

(Biografia është marrë nga www.kujto.al)

BRUNEI
OSE ZYRTARISHT BRUNEI DARUSSELAM

Brunei, zyrtarisht Brunei Darusselam, është një vend në Azinë Juglindore dhe gjendet në bregun verior të ishullit Borneo. Në veri vendi kufizohet nga Deti i Kinës Jugore, dhe të gjitha anët e tjera të tij kufizohen nga shteti Saravak i Malajzisë. Territori i Bruneit ndahet në dy pjesë nga distrikti Limbang i Saravak-ut, në pjesën perëndimore dhe atë lindore, ku pjesa perëndimore është më e madhe se ajo lindore. Brunei është i vetmi shtet sovran i gjendur tërësisht në Borneo, kurse pjesa e mbetur e ishullit është e ndarë midis fqinjëve të tij, Malajzisë dhe Indonezisë.

Brunei ka një sipërfaqe prej 5,765 km2 dhe një popullsi prej 491,900 banorësh (viti 2024).

Kryeqyteti i vendit është **Bandar Seri Begavan** dhe ndodhet në pjesën perëndimore të vendit.

GJEOGRAFIA

Brunei përbëhet nga një fushë e ngushtë bregdetare në veri, e cila u hap rrugën kodrave të thyera në jug. Pika më e lartë e vendit është Maja Pagon (1.850 metra) në juglindje. Brunei drenazhohet nga lumenjtë Belait, Tutong dhe Brunei, në pjesën perëndimore, dhe nga lumenjtë Pandaruan dhe Temburong në pjesën lindore; të gjithë këta lumenj rrjedhin përgjithësisht drejt veriut, në Detin e Kinës Jugore. Belait është lumi më i madh në vend. Tokat e Bruneit janë shumë të gërryera dhe përgjithësisht jopjellore. Tokat më të pasura lymore gjenden përgjatë lumenjve dhe në disa pjesë të fushës bregdetare dhe këto ofrojnë potencialin më të mirë bujqësor.

KLIMA

Klima e Bruneit mbizotërohet nga erërat e musonit ekuatorial. Musoni verilindor zakonisht fryn nga dhjetori në mars, dhe musoni jugperëndimor fryn nga maji në shtator. Prilli, tetori dhe nëntori janë muaj kalimtarë. Temperaturat në Brunei janë të ngrohta gjatë gjithë vitit, ku mesatarja e ulët është rreth 23 °C dhe ajo e lartë shkon në 32 °C, në baza ditore. Reshjet janë mesatarisht rreth 2,900 mm në vit në zonat bregdetare, kurse në zonat më të largëta në brendësi ato mund t'i kalojnë 3,800 mm. Reshjet janë përgjithësisht më të dendura nga tetori në janar dhe më të lehta nga marsi në gusht.

GJUHA

Pothuajse dy të tretat e popullsisë së Bruneit klasifikohen zyrtarisht si Malajzë. Kinezët përbëjnë rreth një të dhjetën e popullsisë dhe pjesa e mbetur e banorëve të Bruneit përbëhet nga popuj të tjerë indigjenë (jomalajzë), të tillë si Iban, popuj të ndryshëm me prejardhje nga Azia Jugore, dhe punëtorë të përkohshëm, kryesisht nga Azia dhe Evropa. Kështu që, gjuha zyrtare në Brunei është malajishtja, me anglishten si gjuhë të dytë kryesore. Po ashtu,

shumë nga kinezët që banojnë atje flasin varietete jugore të kinezishtes dhe shumë nga ata mësojnë Mandarin në shkollë.

FEJA

Islami është feja zyrtare e Bruneit, i ndjekur nga më shumë se 82% e popullsisë. Ata janë kryesisht sunitë, të shkollës Shafi'ite të jurisprudencës Islame.

Besimet e tjera të ndjekura atje janë Krishterimi (6,7%), Budizmi (6,3%, kryesisht nga kinezët), dhe pjesa tjetër e popullsisë janë pothuajse ateistë ose ndjekës të feve indigjene.

EKONOMIA

Brunei është shumë i varur nga të ardhurat nga nafta bruto dhe gazi natyror. Përveç kësaj, Brunei gjithashtu merr të ardhura nga qiratë, honoraret, taksat e korporatave dhe dividentët. Për shkak të natyrës jo të rinovueshme të naftës dhe gazit, diversifikimi ekonomik ka qenë në agjendën e zhvillimit kombëtar të Bruneit. Brunei është prodhuesi i tretë më i madh i naftës në Azinë Juglindore. Ai është gjithashtu prodhuesi i katërt më i madh i gazit natyror të lëngshëm në botë.

Megjithëse Brunei nuk është shumë i madh, kur bëhet fjalë për sipërfaqen tokësore, ai është një vend i bekuar me burime të pasura natyrore dhe ka një vendndodhje strategjike brenda rajonit. Pjesa më e madhe e vendit është e mbuluar me pyje tropikale të mbushura me florë dhe faunë ekzotike. Me synimin për të promovuar ruajtjen e mjedisit të tij të harlisur, eko-turizmi ka fituar rëndësi në aktivitetet ekonomike të vendit.

Burimet njerëzore janë thelbësore për transformimin e suksesshëm të Bruneit në një ekonomi të larmishme industriale. Në vend ka mungesë të fuqisë punëtore të kualifikuar, prandaj, theksi më i madh i kushtohet edukimit. Fushat kryesore të interesit në zhvillimin e burimeve njerëzore janë aftësitë menaxheriale dhe industriale, me theks të veçantë në aftësitë sipërmarrëse si dhe në trajnimin profesional dhe teknik.

Eksportet kryesore të Bruneit përbëhen nga tri mallra kryesore: nafta e papërpunuar, produktet e naftës dhe gazi natyror i lëngshëm. Këto shiten kryesisht në Japoni, Shtetet e Bashkuara dhe vendet e ASEAN.

HISTORI

Megjithëse historia e hershme e Bruneit është e paqartë, dihet se në shekullin e 6-të të erës sonë ky vend tregtonte dhe i paguante haraç Kinës. Më pas ra nën ndikimin hindu për një kohë, përmes besnikërisë ndaj perandorisë Maxhapahit me bazë në Java. Kur anijet e ekspeditës së Ferdinand Magelanit u ankoruan në Brunei në vitin 1521, sulltani i pestë, Bolkiah i madh, e kontrollonte praktikisht të gjithë Borneon, Arkipelagun Sulu dhe ishujt fqinjë. Megjithatë, nga fundi i shekullit të 16-të, territori u copëtua nga grindjet e brendshme. Fuqia e Bruneit ra më pas gjatë shekullit të 19-të, pasi rajoni Saravak (në Borneon veriperëndimor) iu dha aventurierit anglez James Brooke në vitin 1841 dhe më pas ky territor u zgjerua për shkak të granteve shtesë që iu dhanë Brook-it; Britanisë së Madhe iu dha ishulli Labuan që gjendej në Gjirin e Bruneit, dhe humbja e fundit për Brunein ishte shkëputja prej tij e asaj që tani është Sabah në verilindje të Borneos.

Në vitin 1888 Brunei u bë një protektorat britanik, dhe në vitin 1906 administrimi iu besua një rezidenti britanik, këshillat e të cilit sulltani ishte i detyruar t'i pranonte. Pavarësisht pranisë së një administrate të huaj, rëndësia e Bruneit filloi të ringjallet me fillimin e prodhimit të naftës në vitin 1929. Në vitet 1941–45, gjatë Luftës së Dytë Botërore, Brunei u pushtua nga japonezët. Britanikët u kthyen pas luftës dhe filluan negociatat për pavarësinë përfundimtare të Bruneit. Hapi i parë në këtë proces ndodhi në vitin 1959, kur u arrit vetëqeverisja dhe rezidenti britanik u zëvendësua nga një komisioner i lartë. Britania mbeti përgjegjëse për mbrojtjen dhe politikën e jashtme të vendit. Brunei miratoi një kushtetutë të shkruar dhe në vitin 1962 u vendos një Këshill Legjislativ i zgjedhur pjesërisht me autoritet të kufizuar. Konvertimi në një qeveri përfaqësuese u ndërpre më vonë atë vit nga një revoltë, e cila u shtyp me ndihmën e forcave britanike; sulltani më pas shpalli gjendjen e jashtëzakonshme dhe pezulloi shumicën e dispozitave të

kushtetutës. Në vitin 1965 u mbajtën zgjedhjet e reja, por anëtarët e emëruar e ruajtën ende shumicën e tyre në këshill.

Në vitin 1967 Sulltan Omer Ali Sejfuddin hoqi dorë nga froni në favor të djalit të tij të madh, Hassanal Bolkiah Mu'aizzeddin Veddeullah, megjithëse ish-sulltani vazhdoi të ushtronte ndikim deri në vdekjen e tij. Jeta politike e Bruneit ishte e qëndrueshme gjatë viteve 1970 kryesisht për shkak të lulëzimit të ekonomisë dhe pozicionit të saj si një nga prodhuesit më të mëdhenj të naftës në botë (në bazë për frymë). Në vitin 1979 Mbretëria e Bashkuar dhe Brunei nënshkruan një traktat ku Brunei do të bëhej plotësisht i pavarur në vitin 1984. Malajzia dhe Indonezia dhanë garanci se do të njihnin statusin e Bruneit, duke zbutur kështu shqetësimin e sulltanit se shteti mund të përvetësohej nga një nga fqinjët e tij më të mëdhenj.

Brunei fitoi pavarësinë më 1 Janar të vitit 1984 dhe u shpall një Sulltanat Islam. Këshilli Legjislativ, i cili ishte bërë një organ tërësisht i emëruar me dekret të sulltanit në vitin 1970, u pezullua dhe u prezantua një formë ministrore e qeverisjes. Sulltani u bë kryeministër, përfshirë mbajtjen nga ana e tij të disa posteve të tjera ministrore dhe emëroi anëtarë të familjes së tij në shumicën e posteve të tjera, duke caktuar të atin si ministër të mbrojtjes. Kur babai i tij vdiq në shtator të vitit 1986, sulltani e mori vetë edhe atë post.

Në vitin 1990 sulltani inkurajoi bruneianët të përqafonin "Melaju Islam Beraja" (Monarkia Islame Malajze), që përfaqësonte ideologjinë zyrtare të vendit. Lëvizja, e cila lartësonte vlerat tradicionale bruneiane dhe bënte thirrje për respekt më të madh ndaj parimeve tradicionale islame, u pa me ankth nga jomuslimanët, veçanërisht nga anëtarët e komunitetit kinez. Megjithatë, për pjesën më të madhe të fundit të shekullit të 20-të, sulltanati përjetoi stabilitet politik dhe ekonomik, dhe qytetarët e tij vazhduan të gëzonin një standard shumë të lartë jetese.

SI ERDHI ISLAMI NË BRUNEI

Islami ka qenë feja zyrtare shtetërore e Brunei Darusselam-it qëkur qeveria u drejtua nga Sulltan Omer Ali Sejfuddin i 3-të (1950-1967). Nëse shikoni historinë, procesi i sjelljes së Islamit në Brunei Darusselam ka vazhduar që nga shekulli i 10-të. Që atëherë, Islami është pranuar lehtësisht nga njerëzit e Brunei Darusselam-it, derisa u shpall feja zyrtare shtetërore. Në fakt, ky vend ka një rol edhe në përhapjen e Islamit në rajonet e Kalimantanit dhe Filipineve. Në vitin 2016, Islami u bë feja e përqafuar nga më shumë se 80 për qind e popullsisë së Brunei Darusselam.

Sipas ekspertëve, Islami filloi të hyjë në rajonin e Brunei Darusselam rreth vitit 977. Ata që konvertuan Brunei Darusselam në Islam në atë kohë ishin *tregtarët myslimanë të ardhur nga Kina.* Ardhja e tyre ishte në gjendje të përhapte Islamin, i cili u zhvillua për disa shekuj më pas. Zhvillimi i shpejtë i Islamit dëshmohet në kohën e mbretit Avang Alak Betatar, i cili u konvertua në Islam në vitin 1406, duke e bërë atë mbretin e parë musliman të Brunei Darusselam-it. Pasi përqafoi Islamin, Raxha Avang Alak Betatar, i cili konsiderohet themeluesi i Sulltanatit të Brunei Darusselam, e ndryshoi emrin e tij në Muhamed Shah. Gjatë sundimit të sulltanëve në vijim, Islami u zhvillua gjithnjë e më shumë në Brunei, veçanërisht pas vitit 1511, vit kur Malaka u kontrollua nga portugezët.

12

11

Numri i muslimanëve në Brunei u rrit sepse ardhja e portugezëve bëri që ekspertët fetarë muslimanë nga Malaka të shpërngulen në Brunei.

Islami ishte feja zyrtare e Bruneit gjatë sundimit të sulltanit të 9-të, Sulltan Hasanit (1605-1619), në kohën e të cilit u krijuan institucione të ndryshme qeveritare të cilat bazoheshin në ligjin islam. Sulltan Hasani besonte se feja luan një rol shumë të rëndësishëm në drejtimin e politikave të qeverisë së Bruneit drejt prosperitetit.

Brunei gjithashtu formoi një ligj i cili përdori Kur'anin si bazë ligjore për qeverinë. Në periudhën mes viteve 1893-1984, Brunei ishte një koloni britanike, megjithatë Islami vazhdoi të rritej në vend. Edhe në vitin 1959, nën sundimin e Sulltan Omer Ali Sejfuddín-it të 3-të (1950-1967), Brunei Darusselam e shpalli Islamin si fé zyrtare shtetërore.

Brunei Darusselam u bë i pavarur si një shtet islam, nën udhëheqjen e Sulltan Hassanal Bolkiah Mu'aizzeddin Veddeullah më 1 janar 1984. Pas pavarësisë, Brunei vendosi Islamin si themelin e shtetit dhe politikës së tij. Kjo u realizua me themelimin e institucioneve të ndryshme që ishin në përputhje me kërkesat e Sheriatit Islam. Qeveria e Sulltanatit të Bruneit krijoi gjithashtu edhe një Qendër për Studimet Islame, e cila u themelua më 16 Shtator të vitit 1985. Kjo qendër daveti është përgjegjëse për kryerjen e programeve të davetit dhe ato edukative për zyrtarët fetarë dhe komunitetin e gjerë, e gjithashtu shërben si qendër ekspozite për zhvillimet në botën islame. Për çdo ditë të shënuar të Islamit, si ditëlindja e Profetit Muhammed, nata e Zbritjes së Kur'anit dhe nata e Israsë dhe Miraxhit, mbahen festime nga qeveria e Bruneit. Përveç kësaj, edukimi islam në Brunei Darusselam është një faktor shumë i rëndësishëm në zhvillimin e Islamit atje, gjë e cila bëhet me shumë kujdes, në mënyrë që procesi i zhvillimit të Islamit dhe drejtimi i qeverisë të jenë të balancuara. Deri më tani, Brunei Darusselam është i vetmi vend i bazuar në Sheriatin Islam, në rajonin e Azisë Juglindore.

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, *teologe*

https://www.un.int
https://www.kompas.com
https://www.britannica.com
https://en.wikipedia.org

DITA BOTËRORE E KAFESË TURKE NË SHKODËR

Me rastin e 5 dhjetor – Dita Ndërkombëtare e Kafesë Turke, instituti turk "Yunus Emre", Shkodër organizoi ditën e enjte, më 5 dhjetor 2024, aktivitetin"Kafeja Turke për Hatrin 40 Vjeçar".

Në kuadër të kësaj ditë qytetarët shkodranë patën mundësi të shijojnë kafen turke, por edhe të njihen me traditën e hershme të saj.

Në këtë aktivitetet ishte i ftuar edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili pasi falënderoi drejtuesit e institutit për mikpritjen dhe organizimin e këtij aktiviteti shumë domëthënës në mes të tjerave tha:

"Ky aktivitet na lidh me traditën, kulturën dhe trashëgimin e vendit tonë. Dhe kur ke thënë *kafe turke* i ke thënë të gjitha në Shkodër.

Kur kemi kafenë turke pranë nesh kemi në hatër gjithmonë të parët tanë që e kanë trashëguar këtë formë ndeje plot me dije, kulturë dhe vlera.

Dhe pa tjetër, kafja turke është një hallkë prej hallkave të rëndësishme që e mbajnë të gjallë këtë zinxhir të vlerave, që na lidh me trashëgiminë e Hilafetit tonë të Lavdishëm Osman. Ndërkohë ne si shqiptarë, së bashku me popullin turk jemi vëllezër, sespe na lidh historia jonë e përbashkët dhe shpirti i këtij Islami, por edhe i vlerave universale të tij, na lidh vëllazëria mbi 5-së shekullore, ku ne arnautët edhe turqit bashkarisht kuvendonim dhe drejtonim botën, duke jetësuar vlerat më të mira të drejtësisë, të tolerancës, të dijes dhe bashkëjetesës në mes popujve.

Me një kafe turke ne kemi kuvenduar botën dhe kemi dështuar se jemi njerëz të lartë!"

Ndërsa, drejtori i institutit "Yunus Emre" për Shqipërinë, z. Oğuzhan Sakoğlu, pasi falënderoi në mënyrë të veçantë prezencën e Myftiut të Shkodrës, u shpreh se është gjithmonë këndaqësi që ta bashkëndajmë me shkodranët kafen turke.

Ai tha se: "Kafeja turke është prezente prej 11 shekujsh në shumë vende të botës, mes të cilave edhe Shqipëria. Për shumë vite me radhë shqiptarët kanë preferuar kafen turke, gjë të cilën një pjesë e bëjnë edhe sot".

PROF. DR. MEHMET GÖRMEZ: "SHOQËRIA ISLAME DHE KONCEPTI I YMETIT"

Pasdrekën e ditës së shtunë, më 7 dhjetor 2024, në mjediset e hotel Colosseu, Myftinia Shkodër në bashkëpunim me Qendrën e Hulumtimeve "Minber" organizoi një aktivitet me pjesëmarrjen e Prof. Dr. Mehmet Görmez, drejtor i Institutit të Mendimit Islam, në Ankara të Turkiyes.

Fillimisht, përshëndetën Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari dhe drejtori i Qendrës së Hulumtimeve "Minber", Dr. Ferid Piku, të cilët gjatë fjalëve të tyre shprehën kënaqësinë për vizitën e prof. Görmezit në Shqipëri dhe kryesisht në Shkodër, i cili ka kontribuar dhe kontribuon jashtëzakonisht për zhvillimin e metodologjive bashkëkohore të mendimit islam.

Më pas, Prof. Dr. Mehmet Görmez, ish-Kyetar i Dyjanetit Turk në referatin e tij u ndal rreth temës: "Shoqëria islame dhe koncepti i ymetit", ku shpalosi ide frytëdhënëse, koncepte të të kuptuarit origjinal të fjalës ymmet dhe rolit të fesë në lehtësimin e jetës së njerëzve dhe shoqërive bashkëkohore.

Prof. Görmez, theksoj se shoqëria islame më shumë duhet të fokuset në jetën morale të pejgamberëve të Zotit Fuqiplotë si dhe të vlerësoj përzgjedhjen që i ka bërë Krijuesi i gjithësisë ymetit të Muhamedijes si populli i mesëm në besim, adhurim dhe etikë...

Në prezencë të një numri të konsiderueshëm pjesëmarrësish si imamë, teologë, intelektualë, drejtues institucionesh, të rinj dhe të reja, në fund të aktivitetit, Myftiu Sytari, në shenjë vlerësimi dhe nderimi për mikun e madh të shqiptarëve ndau një moment të veçantë, duke i dhuruar Prof. Dr. Mehmet Görmezit një dhuratë simbolike, që simbolizon dijen, si shenjë dalluese e këtij personaliteti me famë botërore.

NJË DITË E VEÇANTË GËZIMI PËR MUEZININ E XHAMISË SË URËS SË BUNËS

Pasdreken e së enjtes, më 5 dhjetor 2024 Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari priti në një takim të posatshëm muezinin e xhamisë së Urës së Bunës, z. Altin Bajrami së bashku me imamin e xhamisë, H. Ridvan Luzaku dhe imamin e xhamisë së fshatit Zues, H. Enes Alushi, në prag të nisjes së muezinit të nderuar për kryerjen e Umres.

Kjo Umre vjen si një dhuratë mirënjohjeje nga Myftinia Shkodër për kontributin dhe shërbimet e kahershme të z. Altin Bajrami në xhaminë e Urës së Bunës, ku prej kohësh ai shërben me përkushtim të madh duke i qëndruar pranë xhamisë dhe xhematit në adhurimet ditore.

Gjatë këtij takimi të përzemërt, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari e përhajroi muezinin e nderuar dhe uroi që udhëtimi i tij të jetë i mbarë dhe kjo eksperiencë e re të jetë një moment i bekuar në jetën e tij.

Myftiu e shoqëroi bisedën e tij me disa këshilla të vyera për muezinin e nderuar dhe njëkohësisht u lut, që zotëria e tij së bashku me vëllezërit e tjerë që e shoqërojnë në këtë udhëtim të kalojnë ditë të mbushura me mirësi, lutje të pranuara dhe adhurime plot dritë në vendet më të mira të globit.

PËRGJEGJËSIT E SEKTORËVE TË MYFTINISË, TAKIM PUNE ME MYFTIUN E SHKODRËS

Paraditën e së xhumasë, më 13 dhjetor 2024, Myfti i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari zhvilloi një takim pune me përgjegjësit e sektorëve në Myftininë e Shkodrës.

Gjatë këtij takimi Myftiu vuri theksin te domosdoshmëria e shfrytëzimit të kohës në shërbim të projekteve dha angazhimeve të shumta, që Myftinia Shkodër ka në shërbim të besimtarëve dhe interesave të Thirrjes Islame.

Në krye të herë, Myftiu vuri theksin te çështja e shfrytëzimit të vakëfeve dhe interesimit për tërheqjen e investitorëve të ndryshëm nga brenda dhe jashtë për të mirën e shfrytëzimit të vakëfeve, që janë një amanet i trashëguar shekullor i muslimanëve të parë.

Gjatë takimit u diskutua edhe rreth ecurisë së punimeve në xhaminë e Plumbit, punime që tashmë po i afrohen fundit dhe me mbarësinë e Allahut (xh. sh), viti 2025 që është edhe viti jubilar i 35 vjetorit të rihapjes së xhamisë së Plumbit, do të shënojë edhe inaugurimin e përfundimit të punimeve për këtë xhami shekullore dhe simbolike për muslimanët e Shkodrës dhe të mbarë Shqipërisë.

Po ashtu u vu theksi te xhamia e Tophanës dhe projekti i ri i saj, punimet për të cilin kanë nisur dhe për këtë, Myftiu kërkoi që të ketë një grup pune për të ndjekur has pas hapi dhe ditë pas dite të gjitha detajet e zbatimit të projektit për të cilin tha, se ka pasur një kosto shumë të madhe për Myftininë e Shkodrës.

Gjatë këtij takimi u diskutua edhe për një sërë aktivitetesh dhe angazhimesh, që Myftinia Shkodër ka planifikuar për fundvitin 2024 dhe fillimin e vitit 2025.

AKTIVITET PËR DITËN BOTËRORE TË GJUHËS ARABE

Paraditen e së mërkurës, më 18 dhjetor 2024, Myftinia Shkodër në bashkëpunim me Medresenë "Haxhi Sheh Shamia", Shkodër, dega e djemve, në kuadër të 18 dhjetorit, të shpallur nga UNESCO, si Dita Botërore e Gjuhës Arabe, zhvilloi një aktivitet me temë: "Gjurmë të arabishtes në trashëgiminë tonë shekullore".

Përveç përfaqësuesve dhe imamëve të Myftinisë Shkodër, ishin të pranishëm, mësues, intelektualë, nxënës të medresesë dhe dashamirës e njohës të gjuhës arabe.

Teologu Arben Halluni në fjalën e tij të hapjes, ndër të tjera tha, se: "Gjuha arabe, si gjuha e Islamit dhe e Kuranit, flitet nga rreth gjysmë miliardi njerëz anë mbanë botës, gjuhë që është përfshirë zyrtarisht si gjuha e gjashtë e OKB-së. Gjuha arabe nuk u quajt "arabishte" shkaku i arabëve, por arabët u quajtën arab, shkaku i arabishtes, sepse arabishtja është më e fortë se racat, më e fortë se fiset, më e fortë se etnitetet, më e fortë se identitetet lokale dhe rajonale. Allahu (xh.sh) e zgjodhi arabishten që të jetë bazamenti mbi të cilin e vendosi shpalljen hyjnore (Kur'anin)".

Më pas e mori fjalën drejtori i Medresesë, z. Kujtim Dervishi, i cili në fjalën e tij vlerësoi organizimin e këtij aktiviteti mjaft të rëndësishëm kulturor dhe arsimor. Ai dha edhe disa statistika të vyeshme të lëndës së gjuhës arabe që nuk është ndaluar asnjëherë në plan-programet mësimore të Medresesë, qysh në hapjes e saj, pas viti 1990.

Ndërsa, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari në fjalën e tij duke u ndal tek gjurmët e arabishtes tek hoxhallarët shkodranë, të cilët në sajë të kontributeve të tyre të çmuar bënë që ajo të quhet tashmë një trashëgimi shekullore e ruajtur brez pas brezi, ndër të tjera tha, se: "Në këtë aktivitet të rëndësishëm jemi të rrethuar nga flladet e ajetit kur'anor: "Thuaj: Zoti im më shto diturinë", dhe e gjeta të shkruar në këto tablo të bukura dhe artistike të kaligrafisë arabe në më shumë se shtatë vende. Që do të thotë se arti i shkrimit të arabishtes është mrekulli në vete, shkencë në vete, sepse është gjuhë e Kur'anit, por jo vetëm, gjuha e matematikës, gjuha e astronomisë, gjuha e letërsisë, gjuha e krejt shkencave, të cilat i dhanë botës zhvillime të jashtëzakonshme, që i dëshmojmë edhe sot e kësaj dite, falë kontributit të nxënësve të arabishtes... ".

Gjithashtu gjatë ligjëratës së tij Myftiu solli në vëmendje kontributet e një elite hoxhallarësh dhe myderrizësh të Shkodrës, të periudhës së shekullit 19-të dhe 20-të, si: Gjurmët e Jusuf efendi Tabakut, Hafiz Ibrahim beg Bushatit, Hafiz Hasan efendi Podgoricës, Haxhi Hafiz Jusuf Repishtit, Haxhi Muhamed Bekteshit, Hafiz Sabri Koçit, Hafiz Myrteza Vucit, Osman efendi Metit, Hafiz Abas Golemit, Hafiz Halil Pukës, Daut efendi Boriçit, Hafiz Adem Kazazit, Hafiz Sheuqet Boriçit, Hafiz Ymer Bakallit, Hafiz Qamil Tresit, Hafiz Esat Myftisë, etj.

Në vijim aktiviteti pati edhe një surprizë mjaft të bukur, ku drejtori i Medresesë, z. Kujtim Dervishi në emër të institucionit që drejton dhe stafit pedagogjik i akordoi Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari një Certifikatë Mirënjohje me motivacion: "Për kontributin, profesionalizmin dhe përkushtimin si mësues i Kur'anit në Medrese si dhe për përkrahjen, mbështetjen dhe promovimin e vlerave edukative, fetare dhe kulturore në zonën e Shkodrës dhe në hapësirën islame mbarëkombëtare".

Në fund të këtij aktiviteti, u shfaq nga një grup medresistësh aftësia për të shkruar arabisht si dhe ekspozita e artit të kaligrafisë arabe.

PËRKUJTOHEN GJURMË TË HOXHALLARËVE SHKODRANË TË SHEKULLIT 19-20 NË QENDRËN KULTURORE TË MES-MYSELIMIT

Pasditen e së mërkurës, më 18 dhjetor 2024, Myftinia Shkodër në vazhdën e aktiviteteve për Ditën Botërore të Gjuhës Arabe zhvilloi një aktivitet kulturor me temë: Gjurmë të arabishtes në trashëgiminë e hoxhallarëve shkodranë të shekujve 19-20, në Qendrën Kulturore të xhamisë së fshatit Mes-Myselim.

Pas fjalës së hapjes mbajtur nga imami i kësaj xhamie, i nderuari H. Fatmir Sulaj, fjalën e rastin e mori Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili nëpërmjet videoprojektorit lëvroi temën e tij duke nxjerr në pah gjurmët e afirmuar të një elite hoxhallarësh shkodranë të shekullit 19-20 në gjuhën arabe.

Gjatë fjalës së tij Myftiu theksoi, se interesimi i hoxhallarëve shkodranë për të ruajtur gjuhën arabe, për ta mësuar atë, për t'u thelluar në të, për ta trashëguar atë dhe për t'ia mësuar të tjerëve buron nga nxitja kur'anore, ku Zoti i gjithësisë na tërheq vëmendjen se ky Kur'an ka zbritur në gjuhën arabe.

Myftiu theksoi, se fakti që Kur'ani ka zbritur në gjuhën arabe i jep kësaj gjuhe një imunitet hyjnor deri në ditën e fundit. Ai theksoi, se gjatë studimeve universitare në Damask në lëndën e Letërsisë Arabe kishte studiuar edhe pjesët e letërsisë arabe të periudhës para islame. Myftiu tha, se gjuha me të cilën është folur dhe është shkruar para më shumë se 15 shekujsh është pak a shumë e njëjta gjuhë arabe me të cilën komunikohet edhe sot, shkruhet dhe lëvrohet anembanë botës.

Gjatë këtij aktiviteti të pranishmit patën mundësi të shohin gjurmë të shumta të hoxhallarëve të Shkodrës dhe kontributin e këtyre hoxhallarëve në ruajtjen e gjuhës arabe nëpërmjet shkrimit.

Aktiviteti u pasua me pyetje, përgjigje dhe me një bashkëbisedim shumë të këndshëm dhe vëllazëror në mesin e Myftiut dhe të pranishmëve.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin edhe imamë të nderuar të zonës së Postribës, etj.

MYFTIU I SHKODRËS, LIGJËRATË ME RININË E XHAMISË KRYE-BUSHAT

Mbrëmjen e së enjtes, më 19 dhjetor 2024, pas namazit të akshamit në xhaminë e Krye-Bushatit, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i shoqëruar edhe nga disa imamë, dha një ligjëratë për rininë dhe besimtarë të zonës së Bushatit, në Qendrën Kulturore Islame të kësaj xhamie.

Aktiviteti nisi me fjalën e rastit, mbajtur nga imami i nderuar, H. Ridvan Luzaku.

Më pas, Myftiu Sytari dha disa mesazhe dhe këshilla me vlerë për të pranishmit, kur ndër të tjera tha: "Dëshmoni se nuk ka Zot tjetër, pos Allahut dhe jetoni si muslimanë, me këdo e kudo! Merrni dhe jepni selam me krejt krijesat e Zotit Një dhe mos u tundoni nga asnjë shfaqje mosbesimi e idhujtarie përreth jush! La ilahe il-lall-llah! Kjo është ajka e krejt të mirave dhe thelbi i dijes dhe zhvillimit! E mira dhe e keqja janë nga Zoti. Nuk e dimë urtësinë e sprovave, me të cilat prekëm gjatë jetës sonë, por e dimë mirë se durimi në sprovë ka shpërblim të pallogaritur! Përhapeni të mirën me të gjithë, muslimanë e jo, sepse marrëdhënia është me Zotin e njerëzve, jo me njerëzit!"

Aktivitetin e përshëndeti edhe z. Zyhdi Mustafa, Kryetar i Këshillit të xhamisë Krye-Bushat, i cili shprehu gëzimin dhe mirënjohjen për këtë mbrëmje fetare dhe uroi që në të ardhmen aktiviteti i Q.K.Islame në Krye-Bushat, të ketë rritje dhe gjallëri.

NË XHAMITË E SHKODRËS BËHET THIRRJE PËR HAXHIN 1446/2025

Hytbeja e xhumasë, më 20 dhjetor 2024, në të gjitha xhamitë e Shkodrës u fokusua te vlerat, dobitë dhe mirësitë e Haxhit, si adhurim me rëndësi si dhe një nga pesë shtyllat kryesore të fesë islame. Në xhamitë e ndryshme të qytetit dhe të fshatit, imamët bënë thirrje besimtarëve që të shfrytëzojnë pasurinë, shëndetin dhe kohën për t'iu përgjigjur thirrjes së Allahut të Madhëruar për kryerjen e Haxhit.

Nga xhamia e "Dy Vajzave", Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari solli në vëmendje të besimtarëve periudha të ndryshme të historisë kur Haxhi ishte ndaluar për arsye dhe shkaqe nga më të ndryshme, të cilat i bëri të ditura për besimtarët.

Myftiu tha, se: "Kur kthejmë kokën pas dhe shohim se përgjatë shekujve Haxhi është ndaluar disa herë, dhe kur shohim se edhe afër kohës sonë, para pak vitesh, për shkak të pandemisë globale koronavirusit, Haxhi u ndalua, kuptojmë se sa me rëndësi është shfrytëzimi i kohës dhe i mundësive për kryerjen e Haxhit në momentin dhe kohën e duhur pa neglizhuar mundësinë e kryerjes së tij.

Secili që e kanë mundësinë shëndetësore, ekonomike, sigurinë e përgjithshme, por jo vetëm, dhe që e ndjen se duhet ta kryejë Haxhin si një borxh dhe një kusht prej kushteve themelore të fesë islame, mos të neglizhojë dhe mos ta lërë për një kohë më pas, sepse ne nuk e dimë se çfarë ndodh më pas.

Në këtë kontekst, të gjithë ata vëllezër dhe motra që janë regjistruar deri më sot dhe ata që e kanë bërë nijet për t'u regjistruar, le të vrapojnë për të hyrë në mesin e besimtarëve që i janë përgjigjur thirrjes së Allahut të Madhëruar për kryerjen e këtij adhurimi të veçantë, për vlerat dhe dobitë e të cilit flasin sa e sa ajete kur'anore dhe hadithe të shumta të Pejgamberit (a.s)".

Gjatë hytbes së kësaj xhumaje, Myftiu përmendi gjithashtu edhe një ndër detajet thelbësore të Haxhit, që është edhe dita e Arefatit, iu vuri në dukje disa hadithe, të cilat dëshmojnë për madhështinë e asaj dite, për mëshirën dhe faljen, që Allahu i Madhëruar shpërndan për mbi besimtarët, sidomos në fushën e Arefatit, por edhe për besimtarët e tjerë jashtë atij vendi të bekuar.

Myftinia Shkodër fton të gjithë besimtarët e interesuar që të shpejtojnë për regjistrimet e këtij viti, të cilat përfundojnë më datën 13 janar 2025.

NË QENDRËN KULTURORE OBLIKË HAPEN KURSET DIMËRORE

Ditën e hënë, më 23 dhjetor 2024 në Qendrën Kulturore pranë xhamisë Oblikë kanë nisur kurset dimëror 2024, me pjesëmarrës rreth 50 nxënës (djem dhe vajza) të moshave të ndryshme, të ndarë në tre grupe.

Krahas mësim besimit dhe edukimit që do të zhvillohen në këtë qendër me fëmijët e kurseve do të ketë edhe aktivitete zbavitëse, ekskursione dhe lojëra argëtuese, përmes së cilave nxënësit do të kalojnë momente dhe çaste të gëzueshme.

Ambientet brenda dhe jashtë qendrës mundësojnë hapësirë të gjerë dhe një larmi aktivitetesh dhe veprimtarish sportive të ndryshme.

Në hapjen e kësaj shkolle intensive, që organizohet nga sektori i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, mori pjesë drejtuesi i arsimit, teologu Arben Halluni, i cili gjatë bisedës me nxënësit i inkurajoi dhe u premtoi se të tjera veprimtari arsimore dhe argëtuese do të zhvillohen në të ardhmen, me fëmijët dhe të rinjtë e mejtepeve të zonës së Anës së Malit, ku përfshihen fshatrat Oblikë, Xhaferaj, Velinaj, Alimetaj, Shtuf dhe Muriqan.

Teologu Halluni dha edhe disa këshilla të dobishme për fëmijët, që do jenë pjesë e këtij aktiviteti.

Ai falënderoi mësuesen e kësaj Qendre, znj. Kimete Elezi, për përkushtimin dhe angazhimin e saj të vazhdueshëm në realizmin e aktiviteteve arsimore dhe kulturore në këtë vatër të moralit dhe të dijes islame.

TEOLOGU HAMJA: "DITËT E FESTAVE JANË DITË TË VEÇANTA TË ZOTIT DHE DITË REFLEKTIMI!"

Paraditën e së mërkurës, më 25 dhjetor 2024, teologu Lavdrim Hamja, i shoqëruar edhe nga imami i xhamisë së Parrucës, H. Naim Drijaj dhe drejtori i Medresesë "Haxhi Sheh Shamia", z. Kujtim Dervishi, zhvilluan vizitat tradicionale në dy kishat e Shkodrës, ku u prit nga autoritetet më të larta të krishtera të qytetit.

Vizita fillimisht filloi në Kishën Ortodokse, pastaj në Kishën Katolike, ku teologu Hamja përcolli urimet e Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, cili për arsye të një udhëtimi jashtë vendit nuk ndodhet në Shqipëri, duke u uruar dy krerëve të Kishave, At Aleksandër Petanit dhe Mons. Angelo Massafra, këtë ditë të veçantë për ta.

Në një mesazh e tij përpara mediave të pranishme, teologu Hamja, ndër të tjera theksoi se: "Ditë e festave janë ditë të veçanta të Zotit dhe janë ditë reflektimi. Secili prej nesh duhet të reflektojë në këto duke u afruar më shumë me Zotin, të kujdesemi dhe të hedhin sytë nga mosha e tretë, ku për shkak të shpopullimit të vendit në qindra familje kanë mbetur vetëm pleq, të cilët kanë nevojë për përkujdesje.

Të lutemi për harmoni, dashuri dhe mirëkuptim me njëri – tjetrin, për të mirën e vendit dhe të shoqërisë, sepse ne të gjithë jemi krijesa të një Zoti të Vetëm. Të lutemi për paqe në mbarë botën, veçanërisht për Gazën e Palestinë, ku terrori sionist nuk e ndal zullumin e tij as në ditët e festa dhe ku deri tani ka shkatërruar komplet Gazën dhe ka vrarë me mijëra njerëz, pjesa më e madhe e tyre, fëmijë, gra dhe të moshuar".

LIGJËRATË ME VLERË: "SHËRIMI SIPAS KUR'ANIT DHE TRADITËS PROFETIKE"

Ditën e enjte, më 26 dhjetor 2024, pas namazit të akshamit, në prani të shumë besimtarëve, Myftinia Shkodër organizoi aktivitetin me temë: "Shërimi sipas Kur'anit dhe Traditës Profetike", në xhaminë e Parrucës, me të ftuar special, Shejkh Halid El-Hibshi nga Arabia Saudite.

Fillimisht përshëndeti teologu Lavdrim Hamja, i cili i uroi mirëseardhjen Shejkhut të nderuar dhe e falënderoi për prezencën e tij, duke i përcjell gjithashtu edhe përshëndetjet e Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili për arsye udhëtimi nuk ishte i pranishëm në këtë mbrëmje fetare.

Pastaj e mori fjalën, Shejkh Halid El-Hibshi, i cili foli për ndikimin dhe vlerën e madhe që ka shërimi përmes ajeteve kur'anore dhe haditheve të Pejgamberit (a.s). Ai solli shumë shembuj praktik nga eksperienca e tij shumëvjeçare në fushën e rukjes, shërimit fetar.

Halid El-Hibshi, një ekspert i njohur në këtë fushë, foli për metoda tradicionale dhe moderne të shërimit që bazohen në Kur'an dhe hadithet e Profetit Muhammed (a.s). Ai trajtoi tema të ndryshme, duke përfshirë leximin e sureve dhe ajeteve të veçanta për shërim, përdorimin e bimëve medicinale dhe rëndësinë e lutjeve të transmetuara nga Pejgamberi (a.s), me bindje dhe besimin se asgjë nuk mund të ndodhë pa lejen e Allahut të Madhëruar.

Ky aktivitet ishte pjesë e në serie të ligjëratave edukative, që Shejkhu i nderuar po mban në vendin tonë dhe që synojnë të ndriçojnë besimtarët mbi rëndësinë e shërimit shpirtëror dhe fizik sipas udhëzimeve islame.

Pas namazit të jacisë, Shejkh Halid El-Hibshi lexoi edhe një rukje të shkurtër gjithëpërfshirëse për besimtarët e pranishëm, të cilët e mirëpritën me shumë dëshirë.

Të pranishmit patën mundësinë të bëjnë pyetje dhe të ndajnë përvojat e tyre personale rreth kësaj teme. Aktiviteti përfundoi me një dua të veçantë, që Shejkh Halid El-Hibshi bëri për të pranishmit.

Më herët, Shejkh Halid El-Hibshi bëri një vizitë në Myftini, ku u prit nga teologu Lavdrim Hamja dhe imami i xhamisë së Parrucës, H. Naim Drijaj.

TRAJNIM ME VLERË PËR HATIBËT RRETH DAVETIT, IRSHADIT DHE KOMUNIKIMIT NË ISLAM

Nga data 23 – 28 dhjetor 2024, në Stamboll të Turqisë, u organizua një trajnim i veçantë dhe me vlerë rreth davetit, irshadit dhe komunikimit në Islam për një grup imamësh nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut. Nga Myftinia Shkodër merrnin pjesë në këtë trajnim imamët e nderuar, **H. Adem Pizga**, imam i xhamisë Perash, **H. Ervis Molla**, imam i xhamisë Barbullush, **H. Ylber Rupa**, imam i xhamisë Zogaj dhe **H. Agron Kastrati**, imam i xhamisë Ajasëm.

Trajnimi, i cili u mbajt në qytetin historik të Stambollit, synonte të fuqizonte aftësitë e pjesëmarrësve në fushën e davetit, irshadit dhe komunikimit islam. Programi përfshinte leksione, diskutime dhe ushtrime praktike që kanë për qëllim të zhvillojnë teknika efektive komunikimi dhe ndikimi, duke theksuar përgjegjësinë dhe rolin e imamëve në udhëzimin e besimtarëve.

Temat kryesore, që u trajtuan gjatë këtij trajnimi ishin:

1. Rëndësia e Fuqisë së të Folurit:

2. Hyrja në Komunikim dhe Komunikimi Ndikues:

3.- Rëndësia dhe Domosdoshmëria e Vetëdisiplinimit në Davet dhe Kauzë:

4. Teknikat për të Ndikuar dhe Teknikat për të Mos Ndikuar:

5. Fjalimi i Papërgatitur:

– Aftësia për të folur spontanisht dhe me siguri.

6. Kontrollimi i Iridiksionit:

7. Ushtrime të Zërit:

8. Përgjegjësia e Davetit dhe Irshadit të Hoxhallarëve:

9. Gabimet Gjatë Komunikimit:

10. Metodat e Ndikimit te Njerëzit:

Trajnimi përfundoi me ndarjen e certifikatave për pjesëmarrësit dhe falënderime për organizatorët dhe trajnuesit. U theksua domosdoshmëria e përvetësimit dhe zbatimit të njohurive të fituara në praktikën e përditshme.

Në përfundim të trajnimit, pjesëmarrësit vizituan disa prej xhamive kryesore dhe vendeve historike në Stamboll.

Pjesëmarrja e imamëve të Myftinisë Shkodër në këtë trajnim vjen në kuadër të bashkëpunimeve të frytshme të Myftinisë Shkodër me Qendrën Minber.

NXËNËSIT E KURSEVE FETARE TË QENDRËS KULTURORE OBLIKË VIZITË NË XHAMITË KRYESORE TË QYTETIT

Edukimi i fëmijëve me edukatën fetare, me besimin te Një Zot i Vetëm dhe me shembullin e të Dërguarit të Allahut (a.s) është garanci për një shoqëri të sigurt dhe me vlera, që ia di vlerën dijetarit, respekton të moshuarin dhe mëshiron të voglin!

Nxënësit e kurseve fetare të Qendrës Kulturore Oblike vizituan xhamitë kryesore të qytetit, "Ebu Bekër, Parrucë dhe Kiras, ku u pritën nga imamët e këtyre xhamive.

MEJTEPI IM... XHAMIA BOKS

Pak histori:

- Xhamia e fshatit Boks ndodhet në Njësinë Administrative Postribë, Bashkia Shkodër.

- Aktualisht, fshati Boks përbëhet me mbi 360 familje myslimane.

- Fiset më të njohura janë: Spahia, Bajraktari, Shabaj, Cekaj, Repaj, etj.

- Me rrëzimin e sistemit famëkeq monist komunist, besimtarët e zonës vendosën të ndërtojnë xhaminë e tyre. Në ndërtimin e xhamisë së re, përveç banorëve dhe Myftinisë Shkodër ndihmoi financiarisht edhe "Bashkësia Islame Botërore e Ndihmave". Xhamia e re me oborr dhe mejtepin e saj u hap më 15 tetor 1994.

- Imami i xhamisë Boks dhe njëkohësisht edhe mësues i mejtepeve që ka shërbyer nga viti 2002 dhe në vazhdim është H. Agim Hoxha.

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar rregullisht rreth 25 mejtepe dhe kurse të ndryshme fetare të mësim-besimit, të zhvilluar në periudha të ndryshme nga viti 2002-2024 është rreth 700 nxënës.

Takimi me nxënësit:

Ditën e diel, më 8 dhjetor 2024, teologu Arben Halluni, përgjegjës i arsimit pranë Myftinisë Shkodër, në vijim të takimeve me nxënësit e xhamive që frekuentojnë kurset/mejtepet e mësim-besimit zhvilloi një takim me nxënësit e mejtepit/kursit fetar në xhaminë Boks me praninë e mësuesit H. Agim Hoxha.

Drejtuesi i sektorit të arsimit, pasi u njoh me ecurinë e procesit mësimor, zbatimin e programit, pjesëmarrjen e nxënësve në mejtep u mbajti një bisedë, duke u përqendruar në rëndësinë dhe vlerën që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që ato mbartin në përçimin e mësimeve të vërteta fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore që duhet të karakterizojë çdo njeri në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit, me krijesat e Zotit në tokë, etj.

Në fund, u zhvilluan pyetje-përgjigje në lidhje me mësimet që marrin nxënësit si dhe u shtrua një koktejl.

Haxhi 2025

KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË

Data e fundit e regjistrimeve: 13 Janar 2025

PËRFSHIHEN:

- Transporti ajror vajtje-ardhje.
- Transporti në Mekë dhe Medine.
- Akomodimi në hotele.
- Ushqimi.
- Kurbani, ujë zemzemi.
- Shoqërimi nga teologë dhe mjekë përgjatë gjithë ritualit.

DOKUMENTET E NEVOJSHME:

- Pasaporta e vlefshme jo më pak se 1 vit. Ndërsa personat që nuk kanë nënshtetësi shqiptare, duhet të paraqesin lejen e qëndrimit, me afat vlefshmërie jo më pak se 6 muaj.
- Fotografi pasaporte.
- Vaksina kundër meningjitit

Regjistrimet kryhen pranë zyrës së Haxhit dhe Umres në KMSH

Rr. "George.W. Bush" Nr. 50, Tirana/Albania | www.kmsh.al haxhi@kmsh.al | Zyra e Haxhit dhe Umres - KMSH | +355 696801100

Botues: **Myftinia Shkodër**
Drejtues: **Imam Muhamed Sytari**

Kryeredaktor: **Lavdrim Hamja**

Tel / Fax: **+355 (0) 224 2081**
Nr. llogarie: **100054 UBA - Shkodër**

MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org

Çmimi: 50 lek